



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА Е МАКЕДОНИЈЕ СЕ ВЕРИУТ
МИНИСТЕРСТВО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА,
ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ - СКОПЈЕ
МИНИСТРИЈА Е ПОЛИТИКЕС СОЦИАЛЕ
ДЕМОГРАФИЈЕ ДНЕЕ ТЕРИЈВЕ - ШКУР

THIRRJE PUBLIKE

për zgjedhjen e përfaqësuesit të të rinjve në Bordin Drejtues të Zyres Rajonale për Bashkëpunim Rinor

Бр. / Nr. 08-2497/6

19-05-2025 20 год. / viti

Hyrje

Çfarë përfaqëson RYKO? Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYKO) është një mekanizëm institucional që funksionon në mënyrë të pavarur, i krijuar nga pjesëmarrësit nga Ballkani Perëndimor 6: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova*, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, me synimin për të promovuar frymën e pajtimit dhe bashkëpunimit mes të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit të të rinjve. Marrëveshja për krijimin e RYKO-s u nënshkrua nga gjashtë kryeministrit e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Samitin e BB6 të mbajtur në Paris më 4 korrik 2016.

Si është organizuar Bordi i Drejtues? Bordi Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i RYKO, i përbërë nga dy përfaqësues nga secila prej palëve kontraktuese (një përfaqësues i qeverisë drejtpërdrejt përgjegjës për politikën rinore dhe një përfaqësues i të rinjve). Përfaqësuesi i Qeverisë do të shërbejë një mandat në përputhje me mandatin e tij në qeverinë e Palës Kontraktuese që ai përfaqëson. Përfaqësuesi i Rinisë duhet të jetë nga moshë 18 deri në 29 vjeç në fillim të mandatit të saj dhe zgjidhet në një procedurë transparente, gjithëpërfshirëse dhe të zhvilluar në mënyrë demokratike dhe në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile që ka të bëjë me rininë. Mandati i përfaqësuesit të të rinjve është tre vjet, pa të drejtë vazhdimi. Bordi drejtues mbledhet një herë në vit, përveç rasteve kur vendoset ndryshe, në ambientet e Palës Kontraktuese që e kryeson atë. Kryesia bën rotacion çdo vit sipas rendit alfabetik të emrave të palëve kontraktuese. Shpenzimet e pjesëmarrjes së anëtarëve të Bordit Drejtues do të përfshihen në Buxhetin e Sekretariatit të RYKO.

Cilat janë përgjegjësitë e Bordit Drejtues? Sipas statutit të RYKO-s, Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për:

1. Miratim të Rregullores së Punës dhe rregulloreve të tjera të nevojshme për funksionimin e RYKO
2. Miratim të planit strategjik trevjeçar dhe planeve operative vjetore, të RYKO,
3. Miratim të Buxhetit Vjetor të RYKO dhe Planit Financiar të RYKO-s për periudhën e ardhshme 3-vjeçare
4. Miratim të Raportit Vjetor të Programit,
5. Miratim të Raportit Vjetor Financiar,
6. Ofrim të mbështetjes politike për planet strategjike, operative dhe financiare të RYKO-s nga palët kontraktuese,
7. Emëron anëtarët e Bordit Këshillimor dhe e autorizon atë, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, të krijojë grupe pune për çështje të caktuara që lidhen me rininë, në kornizat e mandatit të RYKO,
8. Emërimi dhe shkarkimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Sekretariatit,
9. Lidhja dhe përfundimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me pjesëmarrësit dhe organizatat jashtë Palëve Kontraktuese të RYKO,
10. Formim të komisionit përzgjedhës, në të cilin Sekretari i përgjithshëm është anëtar, pas funksionit, përgjegjës për procesin e përzgjedhjes së Sekretariatit dhe stafit të degës lokale

11. Emërimi i auditorëve të jashtëm financiar për RYKO në përputhje me Statutin,
12. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara në Statut.

Aplikimi dhe dokumentet shoqeruese

Kandidati për anëtar të Bordit Drejtues duhet të dorëzojë:

- Formular të aplikimit, plotësuar në formë të shkruar me dorë;
- Biografi e shkurtër (CV);
- 3 letra rekomandimi për të vërtetuar përvojën tuaj (duhet të përmbajë një nënshkrim dhe/ose vulë);
- Kopje të letërnjoftimit;
- Kopje e nënshtetësisë;
- Të paraqesë nominim nga një organizatë që hyn në format e organizimit të të rinjve, e regjistruar në përputhje me Ligjin për pjesëmarrjen rinore dhe politikën rinore.
- Deklaratë se nuk është në marrëdhënie të rregullt pune dhe/ose i angazhuar në administratën shtetërore dhe se nuk është anëtar i asnjë Bordi Drejtues apo mbikëqyrës në një institucion shtetëror, të vërtetuar nga noteri;
- Letër shoqeruese

Me kërkesë të grupit të punës mund të kërkohen dokumente të tjera shtesë për verifikim.

Dokumentet duhet të dorëzohen në formë elektronike në email-adresën rabotnagruparycomk@gmail.com me titullin "Aplikim për përfaqësues të të rinjve në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor" dhe në versionin origjinal të dorëzuar në arkivin e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, me shënimin "TË MOS HAPET PARA SESIONIT ZGJEDHOR", më së voni deri me 02.06.2025 ora 16:30.

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë
rr. Dame Gruev, nr. 14
1000 Shkup

Aplikimet e arritura pas afatit të parashikuar nuk do të merren parasysh. Për të gjitha pyetjet në lidhje me konkursin, mund të na kontaktoni me email: rabotnagruparycomk@gmail.com